



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2843/2 prot.,

Datë 17.11.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR  
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia AI Consulting” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-83007-10-10-2023, me objekt: “*Upgrade i programit te faturimit, migrim i te dhenave, audit dhe web serviseve per pagesa*” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Qarku Shkoder.

**Ankimues:**

BOE “Primus Albania” SHPK me NUIS L42202028V, me adresë: Rruga Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1 Tiranë & “Nexia AI Consulting” SHPK, me NUIS L82210031Q, me adresë: Rruga Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1, Kati 2, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Qarku Shkoder me adresë: Lagjia 3 Heronjte, rruga Marin Biçikemi, Shkoder

Në datën 16.11.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2843/2023 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3612 e BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia AI Consulting” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-83007-10-10-2023, me objekt: “*Upgrade i programit te faturimit, migrim i te dhenave, audit dhe web serviseve per pagesa*” me fond limit 1.500.000 lekë pa

TVSH, zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Qarku Shkoder.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia AI Consulting” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia AI Consulting” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2843 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

### **Arsyet e skualifikimit:**

*Ne baze te pikes 2.3.3 OE ka autorizimin me te vjeter se 3 vite (dt. 19.07.2016) dhe ofron sherbimin J-Billing. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesë autorizimin e sherbimit për "Programin kompjuterik AL Billing" ne nje afat kohor jo me te vjeter se 3 vite te sherbimit për "Programin kompjuterik AL Billing" referuar ligji nr.35/2016,"Per te drejtat e autorit dhe te drejtave te lidhura me to", neni 48 "Kontrata e se drejtes se autorit",pika 4 ku operatori ekonomik te kete autorizim aktiv te vlefshem me afat trevjeçar te referuar kesaj pike.*

*Mbeshtetur ne pikat: 2.3.1 Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere prej 20% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Operatori ekonomik Nextia ka paraqitur furnizime te meparshem te ngjashem, me nje vlere me te vogel se 20% e fondit limit. Referuar pikes 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "Al-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës “Programe Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalente. Gjithashtu mund të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për "Programin kompjuterik AL*

*Billing" Autorizimi eshte leshuar per operatorin ekonomik Jehona Software me date 19.07.2016."*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 17.11.2023.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**